

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Musta Tahiri, me sekretare juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, A.M. nga fshati ..... , Komuna Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.33-4/14 të dt.04.07.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datë 02.09.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Veton Shabani, dëshmitarëve A. dhe A.A., të akuzuarit, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me date 09.09.2016 përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari A.M.** nga fshati ....., Komuna Ferizaj, data e lindjes....., në të njëjtin vend, nga i ati I., e ëma F. e gjinisë A., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, .

### Ë S H T Ë F A J T O R

**1.** Sepse me datë 06.12.2013, rreth orës 14:30, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, në rajonin ekonomik-pyjor Nerodime- Jezerc, në vendin e quajtur “Rapuha”, me qëllim vjedhje ka prerë dy copë drunjë të llojit ahu me diametër 40-45 cm, lartësi prej 20 m gjithsej në kubatur prej 2.59 m<sup>3</sup>, vlera e dëmit të shkaktuar është 349.65 euro, të cilat drunjë i ka bajtur me qerre kuajsh.

**2.** Sepse me datë 03.01.2014, rreth orës 15:50, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj në rajonin ekonomik-pyjor Nerodime –Jezerc në vendin e quajtur “Proni i Vogël”, me qëllim vjedhje ka prerë 8 copë drunjë të llojit ahu me diametër 25-27 cm, lartësi prej 18 m, gjithsej në kubatur prej 3.68 m<sup>3</sup>, vlera e dëmit të shkaktuar është 563.04 euro, të cilat drunjë i ka bartur me qerre kuajsh.

**3.** Me datë 04.01.2014, rreth orës 15:10, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj në rajonin ekonomik-pyjor Nerodime –Jezerc në vendin e quajtur “Proni i Vogël”, me qëllim vjedhje ka prerë 9 copë drunjë të

llojit ahu me diametër 24-28 cm, lartësi prej 16 m, gjatësi në kubtar prej 3,69 m<sup>3</sup>, vlera e dëmit të shkaktuar është 564,57 euro, të cilat i ka batur me qerre kuajsh

**-me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par 1 të KPRK-së**

Në bazë të dispozitës së lartshënuar dhe dispozitave nga neni 358, neneve 4,7,17,41,42,43,45,46, 73 të KPK-së, si dhe neni 365 të KPPK-se të akuzuarin e,

## **G J Y K O N**

**DËNIM ME GJOBË** në lartësi prej 600 € (gjashtëqind euro), i cili denim në mbështetje të nenit 46 par.5 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet :

**ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME** prej 120 orëve, të cilën do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditët, javët që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Në mbështetje të nenit 46 par. 5 të KPRK-së nëse pas kalimit të kohës së caktuar i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj dënimin me gjobë ku për çdo 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, e nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 par.3 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës DPBZHR në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 1477.26 €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## **A r s y e t i m i**

Prokurorisë Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.33-4/14 të dt.04.07.2014, e ka ngarkuar të akuzuarin, A.M. për veprën penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par 1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 02.09.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit, Veton Shabani mbeti në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj. Gjyqtari pasi u bind se i akuzuari e kuptuar akuzën konform nenit 325 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari A.M., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke theksuar se është pënduar për veprën e kryer dhe i ka propozuar gjykatës që ti shqiptojnë dënim sa ma të butë.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- Se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit;
- pranimi i fajit nga ana e të akuzuarve mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht: fletëparaqitja e rojës së pyllit nr.ditarit 02/2014 dt.08.01.2014, procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve për dëmin e shkaktuar nr.12/2014 i dt.09.12.2013, fletëparaqitja e rojës së pyllit nr.ditarit 05/2014 dt.08.01.2014, procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve për dëmin e shkaktuar nr.15/2014 i dt.03.01.2014, fletëparaqitja e rojës së pyllit nr.ditarit 11/2014 dt.08.01.2014, procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve për dëmin e shkaktuar nr.21/2014 i dt.06.01.2014 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësuar nga aspekti juridik në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par 1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin 1,2 dhe 3 të këtij aktgjykimi, ku i pandehuri A.M., në kohën, vendin, mënyrën e përshkruar si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, me

qëllim vjedhje ka prerë drunjët në sasinë e përshkruar si në dispozitivet e lartëpërmendur duke i shkaktuar dëmin e përgjithshëm të dëmtuarës DPB-së në Ferizaj në vlerë prej 1477.26 €.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, rrethana veçanërisht lehtësuese. Gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, pendimin e thellë të kryerjes së kësaj vepre penale, i gjendjes së rënd ekonomike si dhe premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale. Gjykata rrethana rënduese nuk gjeti mbi bazën e këtyre rrethanave, vlerësoj shkallën e rrezikshmërisë dhe peshën e kësaj vepre penale, duke qenë i bindur se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv me bindjen se një dënim i tillë është adekuat dhe proporcional në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe me të njëkohësisht arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale.

Gjyktata konform nenit 463 par.2 të KPPK-së vendosi në tërësi lidhur me kërkesën pasuroro-juridike, andaj të pandehurin e ka obliguar që të dëmtuarës DPPZHR zyra në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 1477.26 €.€, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase provat e mbledhura në procedurë penale paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e plotë të kësaj kërkesë, dhe atë bazuar në procesverbalin nr.12/2014 të datës 09.12.201, procesverbalin nr.15/2014 të dt.03.01.2014 si dhe procesverbalin nr.21/2014 të datës 06.01.2014 me të cilin është llogaritur dëmi i shkaktuar të dëmtuarës.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësorë në shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.724/14 me dt. 09.09.2016**

**Sekretarja Juridike,**  
 Drita Ujupi

**Gjyqtari Individual**  
 Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, Gjykatë së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.